

Nr. **05** Prot.

Tiranë, më 29. 09. 2017

Lënda: Mbi kriteret e vlerësimit të personelit akademik të ftuar për vitin mësimor 2017-2018

VENDIM

Departamenti i Arkitekturës, në mbledhjen e datës 29.09.2017 vendosi:

Kriteret për pranim të personelit akademik të ftuar:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet Master Shkencor (ekuivalent me të) në profilin Arkitekturë, ose të afërt me të, me notë mesatare mbi 7.5. Kandidatet preferohen me mesatare mbi 9 në lëndët e disiplinave ku kërkojnë të kontribuojnë, ose të kenë aktivitet të spikatur profesional në fushën përkatëse.
2. Preferohen kandidatet që zotërojnë gradën doktor ose të jenë në proces të mbrojtjes së Doktoraturës në fushën e Arkitekturës (preferohen studentet e shkollës së Doktoraturës në FAU)
3. Preferohen kandidatët që kanë kryer kurse, kualifikime, apo që kanë bërë publikime brenda ose jashtë vendit, në fushën e specialitetit përkatës dhe që zotërojnë të paktën një gjuhë të huaj të mbrojtur dhe vërtetuar me dëshmi
4. Preferohen kandidatë me eksperiencë në mësimdhënie në specialitetin apo fusha të ngjashme me disiplinat ku aplikojnë për të kontribuar si personel akademik i ftuar.

Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatet për personelin akademik të ftuar:

1. Letër motivimi (specifike për çdo aplikim)
2. Dokument identifikimi
3. C.V. e përgjithshme e përqendruar (short-bio, jo me e gjate se një faqe), portfolio e punëve dhe kopje e botimeve/publikimeve
4. Diploma dhe lista e notave (kopje e noteruar)
5. Dëshmi e gjuhëve të huaja që zotëron
6. Dy letra reference nga persona me grada, tituj shkencorë apo me eksperiencë në mësimdhënie në arsimin e lartë

Shënim: Dorëzimi i dokumentacionit nga kandidatet do të kryhet pranë sekretarisë së Departamentit të Arkitekturës deri në datën 12.10.2017 ora 16.00



Vlerësimi i kandidatëve për personelin akademik të ftuar:

Komisioni i vlerësimit përbehet nga jo më pak se tre anëtarë: përgjegjësi i departamentit, drejtuesi i lëndës, mësimitdhënës i lëndës (apo të lëndëve të ngjashme)

- Vlerësimi i përmbajtjes së dosjes së dorëzuar nga konkurrenti (60 %)
- Vlerësimi i konkurrentit përmes një interviste në komisionin e vlerësimit (40 %)

Në përfundim të procesit, komisioni liston kandidatët në rend zbritës dhe kjo listë shërben për plotësimin e vendeve vakante për mësimitdhënie në lëndën përkatëse

Përgjegjësi i Departamentit të Arkitekturës:

Dr. Denada VEIZAJ